

AKT THEMELIMI
&
STATUTI I
SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
i-NET Event Sh. p. k

Sot më datë 13.12.2021, si themelues me të dhënat e mëposhtme:

- Subjekti “Net-Group” Sh.p.k., e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, me NIUS L72023002P me seli me adresë Tiranë, Rruga “Haxhi Dalliu”, Hyrja 1, Apartamenti 0, me ortak të vetëm z. Valter Begaj, lindur në Fier dhe banues në Tiranë, i datëlindjes 09.11.1972 me letërnjoftim nr. H21109086G

ka vendosur të nënshkruajnë Statutin e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, aktiviteti i së cilës rregullohet nga Legjislacioni shqiptar në fuqi dhe nga ky Statut.

KREU I
FORMA, EMËRTIMI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA

Neni 1 - Forma

- 1.1 Shoqëria “i-NET Event” Sh.p.k (në vijim “Shoqëria”), krijohet në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, dhe veprimtaria e saj rregullohet me anë të këtij Statuti dhe Aktit të Themelimit.
- 1.2 Shoqëria vepron sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.
- 1.3 Akti i themelimit dhe Statuti janë në përputhje me legjislacionit shqiptar që ka karkater të detyrueshëm, ndërsa çështjet që nuk janë shprehimisht të parashikuara në to, plotësohen nga legjislacioni shqipëtar.

Neni 2 - Emërtimi

Emërtimi i Shoqërisë është “i-NET Event “ Sh.p.k

Neni 3–Objekti i shoqërisë

Shoqëria ka për objekt kryerjen e aktiviteteve tregtare në përputhje me legjislacionin Shqipëtar në fuqi.



3.1 Konsulence per shoqerite dhe sipermarrjet, konsulence per manaxhimin administrativ dhe planifikim te shoqerive.

3.2 Hartimin, implementimin e strategjise se brandit dhe marketingut te turizmit, planin e punes, politikat zhvillimore. Realizimin e studimit te tregut (market research) per te matur dhe analizuar strategjite e brandit dhe marketingut te turizmit. Hartimin e strategjise per zhvillimin dhe promovimin e turizmit detar dhe marineve.

3.3 Administrim i objekteve ne bashkepronesi.

3.4 Aktivitete ne fushen e teknologjise, Informacionit, Logjistikes Kompjuterike, dizenjove, teknologji web-I, menaxhim web-page, projektim i sistemit informatik, promovimi i atraksioneve turistike, guida turistike.

3.5 Realizimin dhe Menaxhimin e Eventeve të ndryshme. Hartimi i Strategjive mbi organizimin e Eventeve me qëllim promovimin e turizmit, gastronomisë dhe folklorit vendas.

Neni 4 - Selia

4.1 Selia e shoqërisë është në Tiranë, Rruga "Haxhi Dalliu", Hyrja 1, Apartamenti 0, Tirane.

4.2 Transferimi i Selisë së shoqërisë në një vend tjetër do të bëhet nga Vendimi i Asamblesë së Ortakëve.

4.3 Asambleja e Ortakëve do të vendosë hapjen e filialeve, degëve dhe zyrave përfaqësuese në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë vendit.

Neni 5 - Kohëzgjatja

5.1 Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është pacaktuar.

5.2 Shoqëria mund të priset përpara këtij afati ose mund të zgjasë kohëzgjatjen e saj me Vendim të Ortakëve.

KREU II KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6 - Kapitali themeltar

6.1 Kapitali themeltar është 100.000 (njëqind mijë) Lek.



6.2 Kapitali Themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 (një) kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë), pasi i takon vetën 1 ortakut.

Neni 7 - Kontributet

7.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është ofruar si më poshtë:

- Subjekti "Net-Group" Sh.p.k., subjekt i regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, ofron një kontribut në para të barabartë me 100,000 (njëqind mijë) lekë.

7.2 Sipas kontributeve të mësipërme :

- Subjektit "Net-Group" Sh.p.k., i përket 1 kuote, që i korrespondon 100 % të kapitalit të Shoqërisë;

Neni 8 – Rritja e kapitalit themeltar

8.1 Kapitali themeltar mund të rritet pa kufi në cdo moment, një ose disa herë, me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

8.2 Në rast rritjeje të kapitalit, të gjithë ortakët kanë të drejtën të nënshkruajnë rritjen në raport me pjesët e kapitalit të zotëruara. Në rast se disa nga ortakët nuk e ushtrojnë këtë të drejtë, pjesët e tyre mund të nënshkruhen nga ortakët e tjerë proporcionalisht me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 9 - Zvogëlimi i kapitalit themeltar

9.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin themeltar me vendimin e Asamblesë së Ortakëve. Në cdo rast kapitali themeltar nuk mund të zvogëlohet nën kufijtë e parashikuar nga ligji.

9.2 Zvogëlimi i kapitalit përballohet nga secili prej ortakëve në të njëjtën masë me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre.

Neni 10 - Transferimi i kuotave

10.1 Kuotat janë lirish të transferueshme ndërmjet ortakëve.

10.2 Në rast transferimi në cdo lloj forme, si me shpërblim ashtu edhe pa shpërblim në kuptimin më të gjerë të fjalës, duke përfshirë këtu edhe dhurimin në favor




- të subjekteve të tjerë të ndryshem nga ortakët, kuotat duhet më parë t'i ofrohen në parablerje ortakëve të tjerë.
- 10.3 Në një rast të tillë ortaku që do të transferojë kuotën e tij duhet të njoftoj ortakët e tjerë, me leter rekomande me kthim përgjigje, mbi synimin për shitje, duke përcaktuar cmimin, kushtet, modalitetet, emrin e blerësit dhe afatet e transferimit. E drejta e parablerjes duhet t'i referohet të gjitha kuotave të ofruar për shitje.
- 10.4 Ortakët do të kenë në dispozicion 30 (tridhjetë) ditë nga marrja e letrës rekomande, për t'i komunikuar ortakut që transferon kuotat, synimin e tyre për të ushtruar apo jo të drejtën e parablerjes. Në rast se ata nuk përgjigjen në afatin e caktuar, prezumohet se kane hequr dorë nga e drejta e tyre e parablerjes.
- 10.5 Në rast se oferta pranohet nga disa ortakë, kuotat e afuara nga ortaku qëtransferonkuotat, do të ndahen nga ortakët pranues, në të njëjtën masë me kuotat që atazotërojnë, përvec rastit kur ka një marrëveshje të kundërt. Në asnjë rast, pranuesi i ofertës nuk mund të ushtrojë pjesërisht të drejtën e parablerjes.
- 10.6 Në rast se nuk ushtrohet e drejta e parablerjes, kuotat mund t'u transferohen të tretëve plotësisht apo pjesërisht.
- 10.7 Kuotat mund të trasferohen për shkak trashëgimie *mortis causa*.

KREU III ASAMBLEJA, ADMINISTRATORËT DHE EKSPERTI KONTABËL

Neni 11- Asambleja e ortakëve dhe kompetencat e saj

- 11.1 Organi vendim-marrës i Shoqërisë është Asambleja e Ortakëve.
- 11.2 Asambleja e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për çështjet vijuese: ndryshimet e statutit, emërimi e shkarkimi i administratorëve, ekspertëve kontabël e likuidatorëve, zmadhimi, dhe zvogëlimi i kapitalit, transferimi i kuotave, shpërndarja e fitimeve, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë, miratimi i bilancit dhe për cdo vendim tjetër parashikuar nga ky Statut apo nga legjislacioni përkatës.

Neni 12 - E drejta e pjesëmarrjes dhe e votës



- 12.1 Cdo ortak ka ta drejtë të marrë pjesë në Asamble, të paraqesë mendimin e tij dhe të japë aq vota sa është numri i kuotave që ai zotëron.
- 12.2 Cdo ortak ka të drejtë të përfaqësohet nga një person tjetër jo-ortak, i pajisur me prokurë me shkrim, me anën e së cilës mund të japë votën e tij.
- 12.3 Ortaku nuk mund të lëshojë prokurë për votim për një pjesë të kapitalit që zotëron, në qoftë se voton personalisht për pjesën e mbetur.

Neni 13 - Thirrja e Asamblesë së Ortakëve, Kuorumi dhe Vendimet

- 13.1 Asambleja e Ortakëve thirret të paktën një herë në vit, brenda 6 (gjashtë) muajve nga mbyllja e vitit financiar për miratimin e bilancit, të raportit të Administratorit, ekspertit kontabël si dhe inventarit.
- 13.2 Asambleja mund të thirret në cdo moment nga një prej Administratorëve si dhe prej një ose disa ortakëve që përfaqësojnë të paktën 5% (pesë përqind) të kapitalit themeltar. Asambleja duhet të thirret nëpërmjet njoftimit me letër rekomande me kthim përgjigje me fax apo telegram që duhet t'u dërgohet ortakëve në adresën që rezulton në Librin e Ortakëve - dhe ekspertit kontabël (nëse është emëruar), të paktën 8 (tetë) ditë përpara mbledhjes së Asamblesë. Thirrja duhet të përmbajë informacion mbi llojin e Asamblesë, mbi çështjet që do të trajtohen dhe për të cilat dotë merret vendim, mbi vendin, orën dhe datën e thirrjes së parë dhe të dytë.
- 13.3 Asambleja mund të thirret edhe jashtë selisë së Shoqërisë, vec në Itali ose në Shqipëri.
- 13.4 Në rast se Asambleja e Ortakëve nuk mblidhet me thirrjen e parë për mungesën e kuorumit të parashikuar në pikën 13.7 të këtij Statuti, Asambleja e Ortakëve do të thirret brenda 30 (tridhjetë) ditësh me të njëjtin rend dite.
- 13.5 Mbledhjet e Asamblesë mund të mbahen edhe nëpërmjet telekonferencës dhe videokonferencës, me kusht që të gjithë pjesëmarrësit të mund të identifikohen dhe t'u lejohet atyre të ndjekin diskutimin dhe të ndërhyjnë në momentin e trajtimit të çështjeve në rend të ditës; pasi të jenë verifikuar këto kërkesa që duhet të rezultojnë në procesverbalin e mbledhjes, Asambleja konsiderohet e mbajtur në vendin kundodhet Kryetari në të cilin duhet të ndodhet edhe Sekretari i mbledhjes.
- 13.6 Asambleja do të thirret dhe mbahet rregullisht edhe pa respektimin e formaliteteve të njoftimit, në rast se janë të pranishëm ortakët që përfaqësojnë të tërë kapitalin themeltar.



- 13.7 Vendimet e Asamblesës së Ortakëve, për të cilat kërkohet një shumicë e thjeshtë, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtë vote që zotërojnë më shumë se 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar. Vendimet e Asamblesës së Ortakëve që kërkojnë një shumicë të cilësuar, janë të vlefshme nëse janë të pranishëm ortakët me të drejtëvotë që zotërojnë më shumë se 70% (shtatëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar.
- 13.8 Asambleja e Ortakëve vendos me shumicë të cilësuar ndryshimet e statutit, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, me votën pro të $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e ortakëve të pranishëm. Nën të gjitha rastet e tjera, Asambleja e Ortakëve merr vendime me shumicë të thjeshtëvotash të ortakëve të pranishëm.
- 13.9 Cdo Asamble drejtohet nga një ortak ose ndonjë person tjetër i caktuar nga vetë Asambleja. Për pasqyrimin e vendimit Asambleja emëron një Sekretar, që mund të jetë edhe jo-ortak.
- 13.10 Vendimet e Asamblesës duhet të nënshkruhen nga Kryetari i Asamblesës dhe nga Sekretari.

Neni 14 – Administrimi

- 14.1 Shoqëria administrohet nga një administrator i cili do të qëndrojë në detyrë deri në shkarkim apo dorëheqje ose për një periudhë të prej 5 (pesë) vitesh.
- 14.2 Përfaqësimi ligjor i Shoqërisë i besohet Administratorit. Administratori mund të ushtrojë të gjitha fuqitë konform me saparashikohet në nenin 95 të Ligjit n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 14.3 Administratori mund të emërojë përfaqësues të posacëm për veprime apo kategori të caktuara veprimesh.
- 14.4 Administrator i pare i shoqërisë emërohet z. Valter Begaj

Neni 15- Eksperti kontabël i autorizuar

- 15.1 Në rast se kërkohet nga ligji apo vendoset nga Asambleja e Ortakëve, kontrolli i bilanceve dhe librave kontabël të Shoqërisë mund t'i besohet një ose disa ekspertëve kontabël të autorizuar.
- 15.2 Eksperti kontabël i autorizuar mund të shkarkohet sipas mënyrës së parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

KRE IV VITI FINANCIAR, BILANCI VJETOR, SHPËRNDARJA E FITIMEVE



Neni 16 - Viti financiar dhe bilanci vjetor

- 16.1 Viti financiar fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të secilit vit.
- 16.2 Viti i parë financiar fillon në datën e regjistrimit të Shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe përfundon më 31 dhjetor të të njëjtit vit.
- 16.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e Administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar miratohen nga Asambleja me shumicën e kërkuar nga Ligji n. 9901 të datës 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 16.4 Miratimi i dokumentave që lidhen me vitin financiar duhet të bëhet brenda 6 (gjashtë) muajve që nga fundi i vitit financiar.

Neni 17 – Fitimet

- 17.1 Fitimet që rezultojnë nga bilanci vjetor, u shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesët e kapitalit themeltar të zotëruara.
- 17.2 Asambleja mund të vendosë edhe zbritje të vecanta në favor të rezervave të jashtëzakonshme ose për qëllime të tjera apo dhe shtyrjen e shpërndarjes së fitimeve, plotësisht ose pjesërisht, për vitet financiare të ardhshme.

KREU V SHPËRNDARJADHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 18– Prishja

- 18.1 Shoqëria prishet me përfundimin e afatit të parashikuar nga Statuti, ose përpara përfundimit në rastet e parashikuara nga ligji, ose me anë të një vendimi të Asamblesë së Ortakëve, me shumicën e kërkuar për ndryshimet në statut.
- 18.2 Shoqëria nuk prishet në rast të humbjes së zotësisë për të vepruar, vdekjes, ose falimentimit të ortakëve.

Neni 19 – Likuidimi

- 19.1 Në rast prishje, Shoqëria duhet të likujdohet.
- 19.2 Për të administruar këtë procedurë, Asambleja emëron një ose më shumë likuidatorë, të cilët paraqesin raportet përfundimtare mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të Shoqërisë, mbi operacionet e likuidimit, dhe mbi kohën e nevojshme për të përfunduar likuidimin.



- 19.3 Me përfundimin e procedurës së likuidimit, Asambleja do të vendosë mbi bilancin financiar përfundimtar, mbi punën e kryer nga likuiduesi dhe mbi përfundimin e procesit të likuidimit.
- 19.4 Pas pagimit të kreditorëve dhe mbledhjes së kredive, likuidatori do t'i shpërndajë të ardhurat përfundimtare të likuidimit ortakëve, në proporcion me pjesët e kapitalit të zotëruara prej tyre në kapitalin themeltar.

Neni 20 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 20.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti dhe aktit të themelimit, si edhe atë që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejte ndërmjet palëve të interesuara.
- 20.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, palët mund të bien dakord për zgjidhjen e mosmarrëveshjes nga një kolegji arbitral i përbërë prej tre arbitra.

Neni 21 –Gjuha

- 21.1 Ky Statut është hartuar në 2 (dy) kopje në gjuhën shqipe.

ORTAKËT

Subjekti
"Net-Group" Sh.p.k.
Administrator
z. Valter Begaj

